

KËRKIME GJUHËSORE

Shpëtim ELEZI

PROBLEME RRETH TERMINOLOGJISË GJUHËSORE NË TEKSTET SHKOLLORE

Abstrakt: Në këtë punim mëtohet të vihen në pah dy probleme nga më të dukshmet për sa i përket terminologjisë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në nivelin parauniversitar. Herë-herë çështje të caktuara terminologjike vështrohen përtej këtij niveli duke i parë në përqasje me termat e përdorur në tekstet universitare e akademike.

Të shumta janë problemet me të cilat përballen sot nxënësit në tekstet shkollore, por këtu problematizohet vetëm për dy nga to, që janë: e para, llojllojshmëria e termave në nivele të ndryshme shkollore, madje edhe brenda të njëjtut tekst shkollor dhe, e dyta, mbingarkesa e teksteve shkollore me terma të shumtë, gjë që vë në dukje problemet metodologjike të mospërshtatjes së plan-programeve me moshën e nxënësve.

Këto çështje rreth terminologjisë gjuhësore ilustrohen me shembuj të vjelë nga tekste shkollore të të gjitha niveleve të shkollës fillore dhe të mesme të ulët (nga klasa e parë deri në të nëntën), që përdoren sot në shkollat shqipe në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni.

Fjalët çelës: terminologji, tekst, parauniversitar, mbingarkesë dhe llojllojshmëri termash, fjali, kundrinor, kallëzuesor, përcaktor, sintagmë, fjalor terminologjik, nxënës.

Shpjegimi i saktë e i qartë i termave gjuhësorë në tekstet shkollore ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në formimin gjuhësor të nxënësit, por edhe për përvetësimin e saktë të dijeve. Por, kur terminologjia gjuhësore ndërlikohet në tekstet shkollore parauniversitare, ndërlikohen edhe problemet gjuhësore, ato bëhen të paqarta e të pakuptueshme për nxënësit. Me një fjalë, ndërlikohet dija gjuhësore, në përgjithësi. Problemet rreth terminologjisë gjuhësore në tekstet shkollore parauniversitare e universitare janë të shumta e të mëdha, por, me këtë rast, do të vihen në pah dy nga to: 1) njëri ka të bëjë me llojllojshmërinë e termave të përdorur për të njëjtin koncept gjuhësor dhe 2) tjetri problem me mbingarkesën e teksteve shkollore me terma të shumtë. T'i shohim me radhë:

1. Në përgjithësi, sot terminologjia gjuhësore na paraqitet shumë e pasur dhe e larmishme. Kjo ka ndodhur për shkak të përthyerjeve të shumta të teorive gjuhësore, si rezultat i të cilave janë krijuar terma të ndryshëm nëpër periudha të caktuara. Andaj na rezulton që një koncept linguistik të mbulohet kuptimisht me terma të ndryshëm. Për të ilustruar këtë që sapo u tha, po sjell një shembull në fushën e sintaksës së shqipes, ku për të njëjtin koncept gjuhësor përdoren disa fjalëterma: *fjali*, *frazë*, *periudhë*, *fjali e përbërë*. Pak a shumë, kjo situatë terminologjike e shumëfishtë përcjell të gjitha sistemet e nënsistemet gjuhësore të shqipes. Kjo vërehet edhe në tekstet parauniversitare e universitare, në të cilat përdorimi i fjalëtermave për të njëjtin koncept, për mendimin tim, përbën një

problem jo të vogël sidomos për nxënësin, por edhe për mësuesin, studentin dhe vetë specialistin e gjuhës. Madje, në disa raste, terminologjia gjuhësore e përdorur në tekstet e shkollimit parauniversitar nuk përkon me terminologjinë që përdoret në tekstet akademike. P.sh. në tekstet shkollore të përdorura në Kosovë për klasë të ndryshme të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët¹ përdoren terma, si: *fjali e përbërë, kundrinor, kallëzuesor* etj., të cilët në gramatikën akademike përdoren, si: *periudhë, kundrinë, përcaktor kallëzuesor*² etj. Ndërkaq, kjo njësi e fundit terminologjike në tekstin e klasës së gjashtë në Shqipëri përdoret edhe me termin *kallëzues emëror*.³

Edhe për sa u përket njërive të tjera sintaksore, vihen re dallime në terminologji. Bie fjala, në tekstet shkollore për ciklin fillor e të mesëm të ulët, B. Beci flet për *grupe fjalësh: grup emëror – GE* e *grup foljor – GF*, ndërsa në gramatikën akademike bëhet fjalë për *togfjalësh: me përshtatje, me drejtim* dhe *me bashkim*, koncepte të cilat gjithnjë e më tepër po i mënjanojnë gramatika e sotme. Por edhe brenda teksteve të sistemit parauniversitar për të njëjtin nocion përdoren terma të ndryshëm madje edhe nga i njëjti autor në tekste për klasë të ndryshme. P.sh. B. Beci⁴ në tekstin e klasës së dytë e mëson nxënësin të përdorë termin *grup kryefjalor*, në tekstin e klasës së pestë të njëjtin koncept e quan herë *grup emëror* e herë *grup i kryefjalës*, ndërsa në librin e klasës së nëntë përdor termin *grup emëror*. Në studime të veçanta gjuhësore ky nocion quhet edhe me termin *sintagmë nominale – SN*, ose *sintagmë emërore – SE*, ngjashëm me termin *sintagmë verbale – SV*, ose *sintagmë foljore – SF*.

Për të parë mospërputhjet e mëdha në punë të terminologjisë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni, në mënyrë përfaqësuese do të jap një shembull lidhur me *konceptimin dhe përkufizimin e përcaktorit* në tekste të ndryshme parauniversitare të gjuhës shqipe. Në tekstin e klasës së pestë (Xhevat Syla, *Leximi 5*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2010, f. 157) nxënësi do të mësojë se *përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që e shoqëron emrin në fjali*. Pak a shumë, njëllë me nxënësin më të vogël nga Prishtina do ta mësojë edhe nxënësi i klasës së gjashtë nga Tirana, sepse kështu përkufizohet *përcaktori* në tekstin (R. Petro, N. Pepivani e A. Çerpja, *Gjuha shqipe 6*, Albas, Tiranë, 2010, f. 274-275), ku ai ka lexuar e nxënë: *përcaktori është gjymtyrë e dytë si plotës i fjalisë ... që përcakton emrin bërthamë me të cilin lidhet*. Madje, po në këtë tekst në vijën e gramatikës tradicionale nxënësi do të mësojë se përcaktorët janë *me përshtatje, me drejtim* e *me bashkim*. Të konceptuar si gjymtyrë të dytë të fjalisë, përcaktorin e gjejmë të përdorur edhe në tekstin e klasës së shtatë për Maqedoni (Z. Osmani e F.

¹ Shih B. Beci, *Gjuha shqipe 6*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004; *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë, 2004; *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë, 2005; *Gjuha shqipe 9*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.

² AShSh, *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2002, f. 241, 252; A. Jashari e B. Kryeziu, *Gjuhë amtare*, Prishtinë, 2010, f. 363.

³ R. Petro, N. Pepivani e A. Çerpja, *Gjuha shqipe 6*, Albas, Tiranë, 2010, f. 272.

⁴ B. Beci, *Gjuha shqipe 2*, Pejë, 2004, f. 40; *Gjuha shqipe 5*, Pejë, 2007, f. 59; *Gjuha shqipe 9*, Prishtinë, 2002, f. 111.

PROBLEME RRETH TERMINOLOGJISË GJUHËSORE NË TEKSTET SHKOLLORE

Bojku, *Gjuha shqipe dhe leximi* 7, Shkup, 2009, f. 181, 192). Nëse nxënësi nga Kosova në klasë të pestë, siç u pa më lart, ka mësuar për përcaktorin si *gjymtyrë e dytë e fjalisë*, kur ai të dalë në klasë të shtatë për përcaktorin do të mësojë tashmë si *një përbërës të grupit emëror*, gjegjësisht do të mësojë se *përcaktori është një përemër, një mbiemër ose një emër në rasën gjinore ose me parafjalë që përcakton më mirë emrin bërthamë të një grupi emëror*. (B. Beci, *Gjuha shqipe* 7, Dukagjini, Pejë, 2004). Duke parë për sa u tha pak më lart natyrshëm shtrohet pyetja: Pse gjithë ky pësjtjellim terminologjik e konceptor në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në sistemin parauniversitar për një problem që do të mund të konceptohej fare thjesht dhe njëloj kudo ku mësohet shqip. Lidhur me përkufizimin e përcaktorit, gjuhëtarë me prirje bashkëkohore teorike gjuhësore kanë dhënë vërejtje se *përcaktori i emrit nuk është gjymtyrë e dytë, por element i një grupi emëror (sintagme emërore), fjalën kryesore të të cilit e përcakton*.⁵ Në të katër tekstet e apostrofuara, vetëm në tekstin e klasës së shtatë të B. Becit përkufizimi është i saktë. Në të kundërt, në këso situatash, kur termat për konceptet e njëjta gjuhësore janë të llojllojshme, duke u përdorur ndryshe-ndryshe nga njëri autor në tjetrin, gjegjësisht nga njëri tekst në tjetrin, jo vetëm që mund të shkaktojë huti te nxënësit, por e bën edhe më të vështirë a të pamundur nxënien e tyre nga ana e nxënësve, duke kaluar nga klasa në klasë.

2. Siç u tha në fillim, problem tjetër që vihet re në tekstet shkollore të gjuhës shqipe është ngarkesa apo, më mirë me thënë, mbingarkesa me probleme të shumta gjuhësore, sidomos gramatikore, që në klasën e dytë të shkollës fillore. Përballja e nxënësit me tema të ndryshme nga gramatika, për pasojë përballja e tyre me terminologji veçse të llojllojshme edhe të shumtë sigurisht që e ul shkallën e nxënies së koncepteve gjuhësore e me këtë edhe të problemeve përkatëse. Ja, p.sh., në tekstin e klasës së dytë të shkollës fillore (B. Beci, *Gjuha shqipe*, Pejë, 2006), që është në zbatim në shkollat në Kosovë, vetëm nga lëmi i gjuhës ka afër 30 njësi mësimore, të cilat, ashtu siç paraqiten në këtë tekst mësimor, përfshijnë një pjesë mjaft të madhe të problemeve gjuhësore, si: *teksti, llojet e teksteve, fjalia, vendi i pjesëve në fjali, fjalia më e vogël, llojet e fjalive* (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore – këto vetë nxënësit duhen t'i dinë përmes shembujve të dhënë), *fjalia pohore dhe mohore, ndarja e fjalisë në grupe fjalore (grup i kryefjalës dhe grup foljor), folja, emri, gjinia e emrave, numri i emrave, mbiemri, gjinia e mbiemrave, numri i mbiemrave, zgjedhimi i foljeve, koha e tashme, koha e kryer, koha e ardhme, foljet ndihmëse (kam e jam) dhe zgjedhimi i tyre në të tri kohët themelore, fjala dhe shumëkuptimësia e saj, sinonimet, antonimet, ndryshimi i vendit të grupeve të fjalëve, zgjerimi i grupeve të fjalëve – grupit kryefjalë dhe grupit foljor* (me përcaktorë dhe rrethanorë dhe zgjerimi i fjalive. E brenda këtyre njësisë mësimore përveç termave të përmendur si më lart, që dalin që në titujt e njësisë mësimore, gjejmë edhe të tjerë terma gjuhësorë, si: *kuptim, shkronjë e*

⁵ L. Rugova, Mësimdhënia dhe të nxëniti e gramatikës në shkollë, në: Studime albanologjike II, Tiranë, 2011, f. 247.

madhe, pikë, shenja të pikësimit, pikëpyetje, pikëçuditje, mbaresë etj. A nuk janë të shumtë këta terma gjuhësorë, rrjedhimisht a nuk janë të shumta e të mëdha problemet gjuhësore në një tekst të vetëm që i dedikohet një moshe të vogël, siç janë nxënësit e klasës së dytë? Të mos flasim pastaj se në këtë tekst interdisiplinar janë të gërshetuara edhe probleme nga letërsia, si dhe të folurit, të lexuarit e të shkruarit e shqipes. Me siguri, kjo mbingarkesë jo vetëm që e ul interesimin e nxënësve për lëndën e gjuhës, por, edhe për më keq, ua humb dashurinë dhe interesimin për t'u marrë më tutje me të. Problemi i njëjtë i mbingarkesës paraqitet edhe në tekstet e tjera të këtij autori, të cilat janë hartuar sipas parimit të rimarrjes, përplotësimit dhe të shtimit të njësive tematike.

Si përfundim, e para, që nxënësit shqiptarë, por dhe mësuesit, studentët dhe specialistët e gjuhës, si dhe profanët, të mos ballafaqohen me probleme të këtilla, është e rrugës që të krijohen njësi të caktuara terminologjike si forma të standardizuara, si referencë forma nëpërmjet fjalorëve terminologjikë. E dyta, që nxënësi të mos mposhtet nga denduria e madhe e përdorimit të termave gjuhësorë, është në dorën e institucioneve gjegjëse, gjegjësisht të autorëve të teksteve, që të ndërmarrin hapa të tillë për t'ia përshtatur plan-programet dhe tekstet e gjuhës moshës së nxënësve. Pra, qëllimi është që të arrihet komunikim i qartë e i saktë profesional gjuhësor në të gjitha nivelet e shkollimit parauniversitar e universitar kudo ku flitet e mësohet shqip.

BIBLIOGRAFI

- AShSh (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë.
 AShSh (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Tiranë.
 Beci, Bahri (2006), *Gjuha shqipe 2*, Dukagjini, Pejë.
 Beci, Bahri (2007), *Gjuha shqipe 5*, Dukagjini, Pejë.
 Beci, Bahri (2004), *Gjuha shqipe 6*, Libri Shkollor, Prishtinë.
 Beci, Bahri (2004), *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë.
 Beci, Bahri (2005), *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë.
 Beci, Bahri (2002), *Gjuha shqipe 9*, Libri Shkollor, Prishtinë.
 Bello, Vilma: *Terminologjia gjuhësore e shqipes* (2008), në rev. e SNGjLKSh-së, nr. 27/1, f. 255 – 261, Prishtinë.
 Bello, Vilma: *Terminologjia gjuhësore e shqipes në tekstet shkollore* (2011), në Studime albanologjike I, f. 194 – 196, Tiranë.
 Cabré, M. Teresa (1999), *Terminology. Theory, methods and applications*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia.
 Çitaku, Flutura: *Terminologjia gjuhësore në gramatikat e gjysmës së parë të shek. XX* (2004), në rev. e SNGjLKSh-së, nr. 23/1, f. 415 – 430, Prishtinë.
 Çitaku, Flutura: *Termet e gramatikës në rrafshin konceptor* (2008), në rev. e SNGjLKSh-së, nr. 27/1, f. 131 – 146, Prishtinë.
 Dykro, O. & Todorov, T. (1984), *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjëritimit*, përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë.
 Jashari, A. & Kryeziu, B. (2010), *Gjuhë amtare*, Prishtinë.

PROBLEME RRETH TERMINOLOGJISË GJUHËSORE NË TEKSTET
SHKOLLORE

- Kananaj-Mëhilli, Anila: *Probleme të trajtimit të rrethanorit dhe fjalive rrethanore në tekstet shkollore* (2011), në Studime albanologjike I, Tiranë.
- Kçiku, Ragip (2009), *Fjalor i gjuhësisë*, Ferizaj.
- Kelmendi, Tafil: *Kundrim i disa termave të rinj të sintaksës* (1988), në Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, IAP, f. 65 – 74, Prishtinë.
- Lyons, John (2001), *Hyrje në gjuhësinë teorike*, përkth. E. Lika, Dituria, Tiranë.
- Murati, Qemal: *Për një terminologji më të saktë e më shkencore të gjuhës sonë* (1988), në Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, IAP, f. 60 – 64, Prishtinë.
- Petro, R., Pepivani, N. & Çerpja, A. (2010), *Gjuha shqipe* 6, Albas, Tiranë.
- Rugova, Linditë: *Mësimdhënia dhe të nxënit e gramatikës në shkollë* (2011), në Studime albanologjike II, Tiranë.
- Syla, Xhevat (2010), *Leximi 5*, Libri Shkollor, Prishtinë.
- Titini, Svjetlana: *Vendi i njohurive gramatikore në programet dhe tekstet e gjuhës shqipe në sistemin parauniversitar* (2011), në Studime albanologjike II, f. 224 – 230, Tiranë.